

Vizita në Kulturën Albatros

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Barazia, Mirëkuptimi, Respekti për diversitetin kulturor, Toleranca.

Qëllimet

Pedagogjike: Reflektimi se si faktet, sjelljet dhe eksperiencat e kulturave të tjera ndikojnë në mënyrën si e interpretojmë realitetin tonë dhe të tjerëve.

Praktike: Stimulimi i një ceremonie mirëseardhjeje nga një çift që i përket kulturës “Albatros” për një grup të një kulture tjetër.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 3 pjesëmarrës
Maksimumi: 30 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

15 deri 45 minuta

Materialet

Fleta me përshkrimin e simulimit
Karrige
Objekte të ndryshme (qirinj, aromatizues, mantel)
Ushqim, gota dhe pije


Përmbledhje

Mësuesi/ja zgjedh një djalë dhe një vajzë ose kërkon për vullnetarë (për të përfaqësuar çiftin) që të skenuar simulimin e një vizite në një kulturë të ndryshme nga ajo e vendeve perëndimore. Mësuesi duhet t’i japi çiftit të zgjedhur fletën me përshkrimin e roleve të tyre dhe pak kohë për prova larg dhe që nuk shihen nga klasa.

Përpara fillimit të simulimit, mësuesi/ja duhet t’i shpjegojë klasës se do të mikpritën nga një çift që i përket një kulture tjetër – kultura Albatros – dhe që duhet të përqipen të marrin sa më shumë informacion rreth saj, duke respektuar, ndërkohë, çiftin që do t’i mikëpresë.

Fillimisht, është e rëndësishme të mbajnë në mendje që në kulturën Albatros toka konsiderohet e shenjtë. Në hierarkinë shoqërore gratë janë një rang shumë më sipër burrave. Vetëm gratë mund të kenë kontakt me tokën e shenjtë, kështu që burrave nuk u lejohej të shkelin dretpërdrejt token (prandaj nuk mund të rrinë zbatshur) ose edhe që t’i afrohen asaj (prandaj nuk mund të gjunjëzohen).

Papastërtia mashkullore nuk lejon, gjithashtu, që burrat e Albatros-it të prekin ujin dhe ushqimin prandaj varen totalisht nga gruaja që të mund të mbijetojnë. Gruaja është zgjedhur nga madhësia e këmbës së saj sepse sa më e madhe është këmba më i madh është kontakti me token e shenjtë. Vendosja e duarve në kokën e grave është një shenjë mirënjohjeje e burrit në lidhje me gruan dhe mënyra që burri të mund të jetë me afër tokës së shenjtë e prekur nga gruaja.



Vizita në Kulturën Albatros

Fleta e Mësuesit (vazhdimi)

Shënime

Ky aktivitet duhet të zhvillohet me një grup, ku njohuria dhe ndërveprimi ndërpersonal është i rëndësishëm. Mësuesi/ja duhet të jetë i vetëdijshëm se dinamika e aktivitetit, në ndonjë rast, mund të krijojë një klimë shumë emocionale, të cilën ai/ajo duhet të dijë ta përballojë. Mund të jetë e nevojshme që t'i japë ndonjë ndihmë (jo verbale) pjesëmarrësve të cilët mund të emocionohen më shumë gjatë aktivitetit, si dhe duhet të shmangë komentet ose sjelljet jo verbale që mund të lëndojnë pjesëmarrësit më të ndjeshëm, që kontribuojnë për ndarjen dhe jo për bashkimin e grupit.

Diskutimi

Sapo të mbarojë aktiviteti duhet të procedohet me një eksplorim të plotë. Ndërmjet të tjerash duhet të shtjellohen edhe pyetjet e mëposhtme:

Çfarë vëzhguat gjatë aktivitetit?

Çfarë ju tërhoqi veçanërisht vëmendjen?


Çfarë ndodhi?

Si u ndjenë pjesëmarrësit meshkuj gjatë aktivitetit dhe cili ishte opinioni juaj rreth burrave në kulturën Albatros?

Si u ndjenë pjesëmarrëset femra? Cili është gjykimi juaj rreth kulturës Albatros?

Sipas mendimit tuaj, ka ndryshime midis rolit të meshkujve dhe femrave në shoqërinë tonë? Nëse po, çfarë mund të përmendni? Jeni dakord që të ketë ndryshime?

A keni ndjerë ndonjëherë, që fakti nëse jeni vajzë ose djalë ju ka dëmtuar (ose ndonjë që ju mund të njihni) në ndonjë farë mënyre?



Vizita në Kulturën Albatros

Fleta e Stimulimit

Ceremonia e pritjes e kultures “Albatros”

Ky aktivitet simulon një ceremoni mikpritjeje të organizuar nga një çift i kulturës “Albatros” (një kulturë e fantazuar për këtë aktivitet) për një grup nga një kulturë tjetër. Më poshtë janë rolet e “çiftit Albatros”, të cilat duhet të lexohen, të mësohen përmendësh dhe të përgatiten përpara prezantimit në klasë.

Gjuha Albatros është e përbërë nga vetëm tre tinguj, të vetmet që duhet të përdorni gjatë gjithë ceremonisë:

"Ssssssss!!!" = Do të thotë mohim dhe përdoret për të vënë në dukje një sjellje jo korrekte (jo).

"Mhmhmhmmmm!!!" = Do të thotë aprovim dhe përdoret për të aprovuar një sjellje korrekte (po).

Nëse bën “klok” me gjuhë = përdoret për të dhënë një urdhër për të bërë diçka.


Ceremonia e pritjes duhet të respektojë udhëzimin e mëposhtëm, i cili mund dhe duhet të arrihet me kreativitet, duke patur parasysh vetëm që karakteristikat e roleve të mashkullit dhe të femrës të çiftit të respektohen. Është gjithashtu e rëndësishme që ndërmjet çdo momenti, të shpjeguar si më poshtë, të ketë nga një periudhë të shkurtër heshtje dhe pritje.

Hyrja e pjesëmarrësve në dhomë

Përpara se pjesëmarrësit të hyjnë në dhomë, ku do të bëhet simulimi i vizitës, duhet të informohen se do të priten, si të ftuar, nga një çift me kulturë të ndryshme nga e jona. Kur të hyjnë në dhomë do vënë re një rreth me karrige. Në një nga karriget do të jetë i ulur burri dhe në anë të tij, do të jetë gruaja e gjunjzuar dhe me këmbët zbatshur. Atmosfera e aktivitetit mund të pasurohet me ndonjë objekt (qirinj, aromatizues, ulja e ndriçimit) dhe me rroba të improvizuara (batanije të përdorura si tunika për çiftin).

Pozicionimi i pjesëmarrësve

Pasi të gjithë hyjnë të gjithë “vizituesit”, gruaja “Albatros”, duke përdorur gjuhën e saj të veçantë dhe disa gjeste, u thotë burrave pjesëmarrës që të ulen nëpër karrige. Pjesëmarrëset femra duhet të heqin këpucët dhe të ulen në gjunjë pranë mashkullit që kanë afër. Kur vizituesit të jenë të “sistemuar” het në vendet respektive, gruaja “Albatros” ulet në gjunjë përsëri në pozicionin e saj fillestar dhe rri e heshtur për disa momente.



Vizita në Kulturën Albatros

Fleta e Stimulimit (vazhdimi)

Mirëseardhja

Burri “Albatros” ngrihet në këmbë dhe përshëndet çdo burrë nga grupi. Për këtë i shpjegon secilit prej tyre të qëndrojnë në këmbë dhe pastaj të prekë 3 ose 4 herë me gjunjë, gjunjë e personit që po e përshëndet. Kur “përshëndetja” ka përfunduar, u thotë pjesëmarrësve të ulen përsëri. Pasi ka përshëndetur të gjithë burrat pjesëmarrës, kthehet në vendin e tij dhe ulet. Pak momente më vonë, gruaja duhet të ngrihet dhe të përshëndesi secilën nga pjesëmarrëset femra. Ajo gjithashtu u kërkon atyre që të ngrihen në këmbë dhe përkulet para tyre duke u bërë një masazh të vogël në këmbët dhe thembrat e tyre. Në fund, ajo i urdhëron përsëri pjesëmarrëset të ulen në gjunjë në pozicionin e tyre.

Dhënia e pijes

Pas disa minutave heshtjeje, gruaja ngrihet për t’ju dhënë pije vizitorëve. Për këtë fillon dhe hedh ujë në gotë. Pastaj i jep ujë burrave duke ngritur gotën drejt buzëve të tyre dhe duke mos lejuar asnjë prej tyre që të prekin gotën. Përsa i përket grave, u jep atyre gotat dhe i urdhëron që të pinë ujë vetë.

Dhënia e ushqimit

Pas disa minutash heshtjeje, gruaja ngrihet përsëri për të shpërndarë ushqimin (copa të vogla buke, copa buke të thekur dhe/ose copa të vogla biskotash), të vendosura më parë në një pjatë ose tabaka. Skema është e njëjtë si ajo e përdorur për shpërndarjen e ujit. Gruaja “Albatros” ushqen burrat direkt në gojë (burrat ndalohen përsëri nga gruaja që të prekin ushqimin) dhe pjesëmarrësve femra u vë ushqim në dorë që ato ta hanë vetë.

Zgjedhja e një prej femrave

Pas mbarimit të “ushqimit” dhe disa minutave qetësi, çifti ngrihet në këmbë dhe i drejtohet secilës pjesëmarrëse femër. Kur afrohen te njëra nga femrat, i thonë që të ngrihet dhe shikojnë me kujdes këmbët e saj. Gruaja “Albatros” i prek këmbët për të vlerësuar më mirë madhësinë dhe forcën e këmbës së secilës femër pjesëmarrëse. Në fund, çifti diskuton më vete (duke përdorur gjuhën e tyre të shenjave) dhe zgjedh pjesëmarrësen me këmbët më të mëdha dhe më të fuqishme. Pasi burri ulet përsëri në vendin e tij, gruaja i afrohet pjesëmarrëses së zgjedhur dhe i kërkon asaj që të ulet në gjunjë pranë burrit “Albatros”. Gruaja “Albatros” bën të njëjtën gjë duke u ulur në krahun tjetër pranë burrit.

Duart mbi kokë

Pas një momenti tjetër qetësie, burri “Albatros” fton, me anë të gjesteve dhe duke përdorur gjuhën e tij, pjesëmarrësit meshkuj që të vendosin duart e tyre mbi kokat e femrave pjesëmarrëse të ulura në gjunjë pranë tyre dhe i detyron ato që të ulin kokën drejt dyshemesë. Ai gjithashtu bën të njëjtën gjë me të dy gratë që e ulura në gjunjë pranë tij. Ky pozicion duhet të mbahet pa lëvizur për 2 ose 3 minuta dhe pas tij çifti ngrihet dhe largohet nga dhoma duke marrë me vete pjesëmarrësen e zgjedhur.

